



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić , Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme e MPL-së	
Nga:	Venera Çerkini , Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 29.09.2020 Nr.020-545/15
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës 12 Nr. 400-40372 për shfuqizimin e Vendimit për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale në Komunën e Glllogocit

I miratuar më datë: 23.09.2020

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 24.09.2020

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Za:	Ramiz Lladrovci, gradinačelnik opštine Glogovac Labinot Halilaj, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MLS-a Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MLS-a	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MLS-a	Dana, 29.09.2020 br. 020-545/15
Odgovorni službenici:	1. Službenik za utvrđivanje pravne procene	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština,
	2. Službenik-ca za izradu pravne procene	Vjosa Ahmetaj, viša službenica za monitorisanje opština
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Glogovac	
Vrsta akta:	☐ Odluka skupštine opštine	

Uvažani gradonačelnice,
Uvaženi predsedavajući,


U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, i na osnovu zakonskih ovalčenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 06/2020 o administrativnim oblastima i odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03 / L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka Skupštine opštine 12 br. 400-40372 o ukidanju Odluke za definisanje i parcelaciju svih groblja koja se nalaze na opštinskim imovinama u opštini Glogovac
Usvojena dana, 23.09.2020.godine
Dostavljena na razmatranje u MLS-u dana, 24.09.2020. godine

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta, ocenjuje da je opštinski akt u *proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi* i kao takav može proizvesti pravne efekte. Ministarstvo lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za svako dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNËS



12 Nr. 400-40372 dt. 23.09 .2020

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34. pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, në bazë të nenit 40 pika 40.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, *si dhe në bazë të vendimit të ligjshmërisë nga MPL-së Nr.VI-020-545/13 të dates 19.08.2020, të vendimit për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale të Komunën e Drenasit, Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me date 23.09.2020, miraton këtë:*

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale të Komunën e Drenasit.

Neni 1.

Të shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Drenasit/Gllogocit 12 Nr.352/05-28782 për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në pronë komunale, në të gjitha zonat kadastrale të Komunës së Drenasit.

Neni 2.

Pas shfuqizimit të këtij vendimi duke u bazuar në konfirmimin ligjor të MPL-së në Prishtinë, obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë e Komunës së Drenasit që të njoftoj organet kompetente.

Neni 3.

Me këtë Vendim do të njoftohen organet kompetente të Komunës së Drenasit.

Neni 4.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Halilaj



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA DRENAS
SKUPSTINA OPSTINE

MINISTRIJA E ADMINISTRIMIT E Pushtetit Lokal
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Data: 29.09.2020
Dated: 29.09.2020
Niveli i organizimit: Krye / Leaders: Sitohet / Clerk: -VI- 020-545/15



Br. 12-400-40372, dt. 23.09.2020

Na osnovu clana 11,12 i 40, Zakona br. 03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, clan 34. tacka 34.6, Statuta Opstine Drenas, na osnovu clana 40 tacka 40.1, Zakona Br.03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, i na osnovu odluke o zakonosti iz MLU-ve Br.VI-020-545/13 datuma 19.08.2020, odluke za definisanje i parcelizaciju svih groblja koja se nalaze u opstinskom imanju Opstine Drenas, Skupstina Opstine Glogovac na redovnoj sednici održanoj datuma 23.09. 2020, odobrava ovu:

ODLUKU

Za ukidanje odluke o definisanju i parcelizaciju svih groblja koja se nalaze na opstinskom imanju Opstine Drenas .

Clan 1.

Da se ukine odluka Skupstine Opstine Drenas/Glogovac 12 Br.352/05-28782 o definisanju i parcelizaciji svih groblja koje se nalaze u opstinskom vlasnistvu u svim katastarskim zonama opstine Drenas.

Clan 2.

Nakon ukidanja ove odluke na osnovu zakonske potvrde MLU-ve u Pristini, Uprava za Geodeziju ,Katastar i Imovinu , Uprava za Javne Sluzbe Vanredne Situacije Opstine Drenas duzna je da obavesti nadlezne organe .

Clan 3.

Ovom odlukom obavestice se nadlezni organi Opstine Drenas .

Clan 4.

Ova Odluka stupa na snagu 15 dana od dana registracije i ocene zakonitosti od MLU-ve i 7 dana nakon objavljivanja na zvaničnoj Ueb stanice opstine.

Odluka dostavlja se:

- Kancelariji Presedika Opstine;
- Nadleznoj Upravi;
- Kancelariji Skupstine
- Arhivi .



SKUPSTINE OPSTINE

Minot Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

Nr.01- 352-37708 dt. 08.09. 2020

Në bazë të nenit 58 par. 1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 40 pika 40.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në bazë të vendimit të ligjshmërisë nga MPL-së Nr.VI-020-545/13 të dates 19.08.2020, të vendimit për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale të Komunën e Drenasit, Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2020 të miraton këtë:

PROPOZIM-VENDIM

Për shfuqizimin e vendimit definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale të Komunën e Drenasit.

I.

Të shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Drenasit/Glllogocit 12 Nr.352/05-28782 për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në pronë komunale, në të gjitha zonat kadastrale të Komunës së Drenasit.

II.


Pas shfuqizimit të këtij vendimi duke u bazuar në konfirmimin ligjor të MPL-së në Prishtinë, obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë e Komunës së Drenasit që të njoftoj organet kompetente.

III.

Me këtë Vendim do të njoftohen organet kompetente të Komunës së Drenasit.

IV.

Ky vendim hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Drenasit.

KRYETARI I KOMUNËS:

Edin Lladrovci


A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës së Drenasit sipas Vendimit Nr. 12 Nr.352/05-28772 të datës 30.07.2020 e ka nxjerrë vendim që të bëhet definimi dhe parcelizimi i të gjitha parcelave kadastrale pronë komunale e Komunës së Drenasit, në të cilat ndodhen varrezat, qëllimi i nxjerrës së këtij vendimi ka qenë që të bëhet rrethimi, mirmbajta e këtyre varrezave nga drejtoria për shërbime publike.

Por MPL me vendimin për ligjshmëri Nr.VI-020-545/13 të datës 19.08.2019, ka vlerësuar se akti i komunës së Gllogocit duhet të jetë i harmonizuar me dispozitat e legjislacionit në fuqi, konkretisht me Ligjin nr.04/L-174, Për Planifikim Hapësinor, si dhe Udhëzimit Administrativ 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

Deri në një vendim tjetër të harmonizuar, Kuvendi i Komunës së Drenasit shfuqizon vendimin e lartë cekur.

Vjosa Ahmetaj


From: Vjosa Ahmetaj
Sent: 29 September 2020 15:30
To: Sabrie Rama
Cc: Venera Çerkini; Xhevat Tafa; Florije Kika
Subject: Njoftim....
Attachments: 020-545-13-2020.pdf; 020-545-15-2020.pdf

E nderuar,

Ju njoftoj se Kuvendi i Komunës së Glllogocit pas marrjes së Raportit nga MPL lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë nga MEA se Vendimi 12 Nr. 352/05-28782 për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale, në të gjitha zonat kadastrale të Komunës së Drenasit është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, kanë ndërmarr veprimet konkrete konform legjislacionit në fuqi duke e rishqyrtuar dhe shfuqizuar Vendimin në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur me datë 23.09.2020.

Bashkangjitur gjeni raportin me vlerësimin nga MEA dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës së Glllogocit.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj
Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave – MPL
Tel: +381 (0) 200 35 662
+383 44 473 336



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labino Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit		
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MEA-së		
Nga:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MPL	Data:	18.08.2020
Zyrtarë përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	Nr.020-	545/8
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit		
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës		

Inderuar Kryetar,
Inderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendim 12 Nr. 352/05-28782 për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale në Komunën e Drenasit, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.



Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine
Ministry of Economy and Environment



Për:	Goran Rakić, Ministër në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Blerim Kuçi, Ministër i MEA Mentor Sylmeta, ud.Sekretar i Përgjithshëm i MEA
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Minister,
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Rregulloren (QRK) Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm

të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 12 Nr. 352/05-28782 për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale në Komunën e Drenasit, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gillogocit

I miratuar me datë: 30.07.2020

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 03.08.2020

I dërguar për shqyrtim në MEA, me datë: 05.08.2020

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Hyrja e Vendimit.	Hyrja e Vendimit duhet të ketë referencë në Ligjin Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor
2.	Vendimi	- Vendimi duhet të jetë i bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor sipas Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, dhe dokumentet tjera që janë të parapara me këtë ligj; - Nuk lejohet destinim tjetër apo shfytëzueshmëri tjetër nga ajo që është e paraparë me dokumentet e planifikimit hapësinor pjesën tekstuale dhe pjesën grafike në fuqi sipas Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor. - Sipas Udhëzimit Administrativ 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e

		Hartës Zonale të Komunës. Neni 12 paragrafi 6, parashihet formimi i parcelës kadastrale e për zhvillim që nënkupton (ri-parcelizim) Prandaj, Komuna e Glllogocit duhet të finalizoi Hartën Zonale të Komunës.
--	--	---

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, i propozon MAPL-së, që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.